



Nr. 2056 Prot, dt. 25.06.2024

Nr. _____ Prot, dt. _____ 2024

Universiteti Bujqësor i Tiranës
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Megatek S.A

E lidhur sot më datën 25.06.2024, ndërmjet palëve:

"Universiteti Bujqësor i Tiranës" me seli në Rr. Pasi Vodica Nr. 1025, Kodër Kamëz, Tiranë, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NIPT) **J61915028N.**, përfaqësuar nga Prof. Dr. **Fatbardh Sallaku**, Rektor;

dhe

"Kompania Megatek s.a", me adrese: Katund i Ri, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 6, kthesa e Rinasit, Tiranë, Shqipëri, me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit **NIPT: K81607050Q**, përfaqësuar nga **Z. Dionis Teqja**, Administrator.

Mbështetur në mundësitë për bashkëpunim dhe partneritet dypalësh në kuadër të zhvillimit institucional apo ekonomik dhe transmetimin e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga institucionet e Arsimit të Lartë, të dyja palët e mësipërme, bien dakord të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

Neni 1
Parime të përgjithshme

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis dy entiteve nënshkruese lidhur me përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit që zhvillohen në UBT dhe që lidhen me aktivitetin e kompanisë **Megatek**. Kjo do realizohet nëpërmjet bashkërendimit të përmbajtjes teorike me aspektet praktike për një përgatitje sa më cilësore dhe profesionale të studentëve të UBT-së të anagazhuar pranë kompanisë **Megatek**.
2. Dy entitetet angazhohen të punojnë së bashku në frymën e asistencës, reciprocitetit, barazisë, transparencës, qëndrueshmërisë, lehtësimit të pjesëmarrjes duke u përpjekur të mos cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit në bazë të të cilit ato janë krijuar dhe funksionojnë.
3. Kjo marrëveshje synon shfrytëzimin sa më të mirë të informacionit, teknologjise, infrastrukturës funksionale dhe intelektuale të të dy entiteve. Për objektiva të veçanta, projekte institucionale dhe bashkëpunime kombetare apo ndërkombëtare me interes reciprok këto entitete mund të hartojnë marrëveshje funksionale me objekt bashkëpunimi të përcaktuar nga nevojat.



Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

Palët angazhohen për të bashkëpunuar në fushat e mëposhtme:

- Bashkëpunim në fushat e Praktikave profesionale, orëve të hapurave, panairove dhe punësimit.
- Investime konkrete si psh: produkte dhe pajisje të ndryshme për laboratorët e **UBT-se** me qëllim përmirësimin e procesit të mesimdhënieve.
- Bashkëpunim për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve të **UBT-se** në mjediset e kompanisë **Megatek**.
- Mundësimin e punësimit të një numri studentësh me rezultate të larta dhe që tregojnë aftësi profesionale të mira gjatë kryerjes së praktikave profesionale në mjediset e kompanisë **Megatek**.
- Angazhimin e përfaqësuesve të kompanisë **Megatek**, si lektorë dhe në aktivitete të ndryshme promovuese si psh: (i) *Ditet e Hapura për Bizneset* dhe (ii) *Panaire*.
- Angazhimin e stafit dhe infrastrukturës së dy entiteteve në fusha bashkëpunimi me interes reciprok.
- Informimin reciprok mbi të rejat dhe zhvillimet e fushave, ku operojnë të dy palët dhe që paraqesin interes për palë të tjera.
- Shkëmbim të materialeve, informacioneve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore që realizohet ngastafi i të dy entiteteve.
- Publikimi i shërbimeve që kompania **Megatek** ofron, në portalin **UBgreen** të **UBT-së**.
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok.
- Mundësimin e projekteve, programeve dhe financimeve të përbashkëta me interes të ndërsjellë.
- Shkëmbim të stafit dhe ekspertëve të dy palëve me qëllim zhvillimin e trajnimeve dhe kualifikimin e mëtejshëm të personelit.
- **UBT** nëpërmjet stafit të saj, ofron shërbime të konsulences sipas nevojave të kompanisë **Megatek**.
- Mbeshtetjen e studentëve të Masterit Shkencor dhe Doktoraturës për realizimin e praktikave dhe intershipëve në kompaninë **Megatek**.
- Të mbështesin njëra – tjetrën në realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok.
- Të bashkëpunojnë edhe në raste të tjera, për të cilat palët bien dakord në të ardhmen.

Neni 3

Konfidencialiteti i të dhënave



- 1) Secila palë do të mbajë konfidencialitetin e Informacionit, përmbajtjes dhe të dhënave të kësaj kontrate apo qërrjedhin prej saj dhe nuk do ta zbulojë atë nëse nuk ka marrë më parë pëlqimin me shkrim të palës tjetër.
- 2) Secila palë do ta përdorë informacionin e marrë vetëm sipas pikave të kësaj marrëveshjeje.
- 3) Secila palë do të mbrojë konfidencialitetin e Informacionit të palës tjetër duke përdorur të njëjtat masa të arsyeshme sigurie që përdorin për efekte të punës brenda institucionit të tyre.

Neni 4 Pronësia Intelektuale

Kur si rezultat i bashkëveprimeve të kryera në përputhje me këtë Marrëveshje, realizohen produkte që janë objekt i së drejtës mbipronësinë intelektuale, ato do të mbajnë pronësinë e përbashkët të kompanisë **Megatek** dhe **Universitetit Bujqësor Tiranë**. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve për këto çështje do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5 Njoftimet midis palëve

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm dhe të shkëmbejnë çdo informacion të cilin e konsiderojnë të nevojshëm për punën e tyre. Personat e kontaktit për zbatimin e Marrëveshjes janë:

Universiteti Bujqësor i Tiranës – **Prof. Romina Koto**, me detyrë Zëvendës rektore për marrëdhëniet me institucionet dhe publikun,, me numer kontakti **0674346616**, e-mail: **rkoto@ubt.edu.al** dhe adrese postare 1029 Koder-Kamez.

Kompania Megatek, Blerta Kosturi, Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore, me numër kontakti: +355 069 20 600 12, adresë email-i: **Blerta.Kosturi@megateksa.com**.

Neni 6 Kufizimet e marrëveshjes

1. Palët bien dakord që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
2. Për çdo veprimtari tjetër, që përputhet me frymën e kësaj marrëveshjeje, palët kanë të drejtë të formulojnë e nënshkruajnë marrëveshje të veçanta bashkëpunimi dhe partneriteti.

Neni 7 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërmjet palëve.



Neni 8

Ndryshimi dhe revokimi i Marrëveshjes

1. Çdo nen i kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet ose revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy palëve.
2. Çdo ndryshim apo revokim i marrëveshjes do të bëhet pasi pala e interesuar të njoftojë me shkrim palëntjetër 30 ditë para, në rast se dëshiron të rishikojë, përmirësojë ose të tërhiqet nga kjo marrëveshje.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga palët dhe do t'i shtrijë efektet për një periudhëkohe të pacaktuar.
2. Kjo Marrëveshje hartohet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje origjinale.

Palët, pasi e lexuan kontratën dhe e gjetën konform vullnetit të tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht.

Për:

Kompanine MEGATEK

Dionis TEQJA



Universitetin Bujqësor Tiranë

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

